



BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ prot

Datë: ____ .07.2026

L e n d a : Dërgojmë “Njoftim për publikim vend të lira pune ” në faqen tuaj

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Adresa : Bulevardi “B.Curri”, pranë ish – “Hotel Arbana”

T I R A N Ë

Bashkëngjitur Ju dërgojmë “**Njoftim për publikim vendi të lirë pune**” në Bashkinë Mirditë, për publikim në faqen tuaj, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore në RSH-së”, në Kodin e Punës të RSH-së i ndryshuar, Vendimit nr.97, datë 10.12.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë dhe institucioneve vartëse, për vitin buxhetor 2026” konfirmuar me shkresën Nr.1240/2 Prot., datë 22.12.2025 të Prefektit të Qarkut Lezhë (protokolluar në institucionin tonë me Nr.6071/3 Prot., datë 29.12.2025), Vendim Nr.32, datë 29.05.2026, shkresa me Nr.2393 Prot., datë 29.05.2026 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë-Institucioneve të varësisë dhe Njësive Administrative”.

Ndërkohë të njëjtat materiale janë dërguar në adresën tuaj elektronike nga “Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore”

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Sekretari i Përgjithshëm

Artur Lazri

KRYETARI

ALBERT MËLYSHI



BASHKIA MIRDITË

Nr. _____ Prot

Datë ____ .07.2026

NJOFTIM “Për vend të lirë pune ”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore në RSH-së”, në Kodin e Punës të RSH-së i ndryshuar, Vendimit nr.97, datë 10.12.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë dhe institucioneve vartëse, për vitin buxhetor 2026” konfirmuar me shkresën Nr.1240/2 Prot., datë 22.12.2025 të Prefektit të Qarkut Lezhë (protokolluar në institucionin tonë me Nr.6071/3 Prot., datë 29.12.2025), Vendim Nr.32, datë 29.05.2026, shkresa me Nr.2393 Prot., datë 29.05.2026 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë-Institucioneve të varësisë dhe Njësive Administrative”, Bashkia Mirditë shpall vend të lirë pune:

1 (një) pozicion “Teknik Pyjesh” –Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Mirditë

I- PËRSHKRIMI I PUNËS

- 1- Kontrollon në terren zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor vendor nga subjektet private e publike, juridike e fizike.
- 2- Parandalon, zbulon rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të pyjeve, të tokës pyjore, kullotave dhe livadheve brenda territorit të tij administrativ.
- 3- Bashkëpunon me strukturat e ngarkuara me këtë ligj dhe ligje të posaçme, për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.
- 4- Parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit dhe të tregëtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, si dhe çdo veprimtari tjetër që bie në kundërshtim me ligjin.
- 5- Njofton dhe bashkëpunon me Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për shkeljet që parashikon në kodin penal në fushën e pyjeve, kullotave .
- 6- Njofton dhe bashkëpunon me policinë e shtetit për shkeljet që konstatohen në fondin pyjor \kulllosor .

- 7- Bashkëpunon me specialistët e pyjeve për përgatitjen e projekteve për ndërhyrjet në fondin pyjor kullor.
- 8- Siguron dhe jep mbështetjen teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve private dhe të komuniteti.
- 9- Organizon trajnime dhe shërbime këshillimore për pronat private .
- 10- Kontrollon punime të kryera në pyje dhe kullota pavarësisht nga burimi i financimit.
- 11- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës në fondin pyjor dhe kullor .
- 12- Drejtojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e zonave të gërryera, luftimin e gërryerjeve rrëshqitjen e ortekeve brenda territorit të njësisë .
- 13- Ndikon në dhënien e një ndihme të madhe në zhvillimin e agro-pyllumtarisë në territorin e bashkisë.
- 14- Identifikon sëmundjet dhe dëmtuesit në fondin pyjor.
- 15- Në zonat pyjore, të caktuara nga specialistët për çlodhje, argëtim, turizëm dhe për pritjen e publikut, teknikët pyjor caktojnë vendqëndrimet dhe rrugët e lëvizjes, si dhe vendet ku mund të lejohet ndezja e zjarreve .

II- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë me postë apo drejtpërsëdrejti, në zyrën e protokollit pranë Bashkinë Mirditë, deri më dt. **30.07.2026 ora 15:00** dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë personale/ letër motivimi për vendin e punës
2. CV (Curriculum vitae)
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave, Bachelor/Master (të noterizuara); për diplomat e marrë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet njëhësimi sipas legjislacionit në fuqi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
4. Fotokopje të librezës së punës (të noterizuar);
5. Dëftesë e Shkollës së Mesme Profesionale (fotokopje e noterizuar)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
7. Dëshmi penaliteti, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë;
8. Vërtetim nga gjykata se nuk është në proces shqyrtimi gjyqësor ;
9. Vërtetim nga prokuroria se nuk është në procedim penal ;
10. Vërtetim për konfirmimin e gjendjes shëndetësore;
11. Fotokopje e letërnjoftimit elektronik (ID)
12. Fotografi (2 copë)

Mungesa e një prej dokumenteve apo pavlefshmëria e tyre, sjell mos kualifikimin e kandidatit.

III- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë në proces procedimi apo shqyrtimi penal në prokurori apo gjykatë;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g) Të zotërojnë formimin përkatës profesional në degën e inxhinierisë së pyjeve ose degë të tjera të lidhura me pyjet dhe mjedisin ose të kenë diplomë të nivelit 4 ose 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në një nga drejtimet e profilit “pyje”, të ofruara në shkollat e arsimit të mesëm profesional.

- **Testimi do të zhvillohet me datë 03.08.2026, ora 11:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, pranë “Godina e Shërbimit të Qytetarëve”, kati I-rë.**
- **Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën 05.08.2026, ora 11:00 (në të njëjtin ambjent si më sipër).**

Për çdo paqartësi apo detaje më të hollësishme paraqituni pranë Bashkisë Mirditë.

BASHKIA MIRDITË